



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Zyra e Kryetarit të Komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, njofton qytetarët se hapet për:



DISKUTIM PUBLIK

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2026 - 2033

Duke pasur parasysh përmbushjen e kërkesave të qytetarëve dhe zbatimin e dispozitave ligjore, Komuna përdor mekanizmin e konsultimit publik dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e hartimit dhe propozimit të vendimeve me interes për qytetarët.

Andaj, pas miratimit në lexim të parë në Kuvendin Komunal, më datë 31.07.2026, Zyra e Kryetarit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, e hap për diskutim publik Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2033,

nga data 20.08.2026 deri më 20.09.2026.

Vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe komentet tuaja mund t'i dorëzoni në Zyrën e Kryetarit, në objektin e Komunës apo në email: besart.tofaj@rks-gov.net, ku mund të siguronit edhe materialet për shqyrtim, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në orën 12:00. Dokumentin mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Nga: Besart Tofaj – Nënkryetar i Komunës / Kryesues i Grupit Punues

Përmes: Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës



Datë 20.08.2026